Njoftim datë 31 Gusht 2017

Në bazë të Nenit 15 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 7.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni" i ndryshuar, Ministria e Energjisë dhe Industrisë njofton si më poshtë:

Shoqëria "2FAF" Sh.P.K., ka shprehur interesin dhe ka paraqitur pranë Ministrisë, aplikimin për ndërtimin e një parku fotovoltaik për prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme, me kapacitet 2 MW, në zonën në "Njësinë Administrative Roskovec, fshati Jagodinë – Bashkia Roskovec".

Përshkrim i Projektit:

Shoqëria "2FAF" Sh.P.K. ka aplikuar për pajisjen me autorizim paraprak në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 7.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni" i ndryshuar, për ndërtimin e një parku fotovoltaik në Zonën në "Njësinë Administrative Roskovec, fshati Jagodinë – Bashkia Roskovec".me një sipërfaqe totale të projektit rreth 26,400 m2 ku kapaciteti i instaluar do të jetë 2 MW me një vlerë investimi rreth 1.7 milion Euro.

Aplikimi i detajuar për publikun e interesuar, të Shoqërisë "2FAF" Sh.P.K. mund të gjendet pranë ambienteve të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

Adresa: Bulevardi Dëshmorët e Kombit, 1001 Tiranë, Faqja web: www.energjia.gov.al

Afatin për dërgimin e objeksioneve ose komenteve në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë është 15 dite, duke nisur nga data e publikimit të këtij njoftimi në faqen zyrtare: www.energjia.gov.al